




REPUBLIKA E KOSOVË AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u> Nr. llog. Broj. stranica <u>02</u> Nr. pages	Nr. Prot. Bi Prot. Prot. No <u>01-78/15</u> Data Datum <u>16-01-2015</u> Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	15.01.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Fehmi Mehmeti Zëvendësguvernator i Mbikëqyrjes Financiare znj. Suzan Dërvvari Drejtor Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

Të nderuar,

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-5036/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Agjencia, ndër të tjera, "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", si dhe ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në tërësi. (Neni 19, pika 1.5, dhe 1.6 të Ligjit Nr.04/L-051).

Prandaj, bazuar në kërkesën tuaj, se a paraqet konflikt interesi nëse djali i Anëtarit të Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (përkatësisht Zëvendësguvernatorit për Funksione të përgjithshme) zgjedhet zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë e Sigurimeve “Dardania”, duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kemi nxjerr këtë:

OPINION

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk ka ndonjë dispozitë kufizuese që i pamundëson zgjedhjen për Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë e Sigurimeve “Dardania” personit i cili njëkohësisht është djali i Zëvendësguvernatorit për Funksione të përgjithshme në BQK.

Përzgjedhja e tij nuk paraqet konflikt faktit të interesit por mund të jetë konflikt “rast për rast” në ndonjë vendimmarrje të caktuar.

Arsyetim

Lidhur me pyetjen tuaj se a paraqet konflikt interesi nëse djali i Anëtarit të Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës zgjedhet zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë e Sigurimeve “Dardania”, në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk është paraparë ndonjë ndalim në këtë rast.

Në bazë të informacioneve që kemi marrë nga BQK, çështja e licencimit apo mbikëqyrjes të kompanive të sigurimeve, në rastin konkret të kompanisë “Dardania”, nuk hyn në kompetencat e zëvendësguvernatorit për Funksione të përgjithshme.

Megjithatë pika 1 e nenit 13 të ligjit PKI përcakton se “Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Për këtë arsye, anëtari i Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore ka për obligim që ta bëjë deklarimin rast për rast të konfliktit të interesit dhe të shmanget paraprakisht nga proceset e vendimmarrjes të cilat në ndonjë mënyrë apo tjetër kanë të bëjnë me kompaninë e sigurimeve “Dardania”.

Dy paragrafët tjerë të nenit 13 parashohin se:

2. *Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.*
3. *Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.*

Me respekt!